



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 11 korrik 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Behar Selimi dhe Armend Zemaj.

**Munguan:** Mufera Şinik, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Jasmina Zhivković dhe Ibrahim Makolli.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati - ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Donal O'Sullivan – EULEX, Artan Canhasi – EULEX, Isuf Zejna – KDI, Saranda Xhekaj – Gazeta Lajm, Agon Vrenezi - OHCHR dhe Fixhrije Dragaj, praktikante.

**Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.6. 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve me amendamentet e propozuara nga grupi punës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas me amendamentet e propozuara nga grupi punës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për nisma legjislative;
6. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë nr. 04-P-039/k i datës 5 korrik 2011;
7. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21. 6. 2011**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21. 6. 2011 pa vërejtje.

## **3 Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve me amendamentet e propozuara nga grupi punës**

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e amendamenteve të paraqitura nga grupi punës. Pas shqyrtimit të amendamentit të parë, kur duhej të votohej, deputeti Halit Krasniqi u largua nga mbledhja dhe kjo shkaktoi mungesë të kuorumit.

Kryetrari e shpalli të mbyllur mbledhjen për mungesë kuorumi.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

---

Arben Gashi